

V E N D I M
Nr.584, datë 28.8.2003

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE¹

(Ndryshuar me VKM nr.201, datë 29.03.2006; nr.4, datë 7.01.2009; nr.233, datë 18.03.2015; nr.653, datë 14.09.2016; nr.197, datë 11.4.2018; nr.613, datë 24.10.2018; nr. 35, datë 24.1.2024; nr. 559, datë 8.10.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, 22 pikat 2, 23 pika 2, 24 pikat 4 dhe 25 pika 4 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullore së Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vendimi nr.81, datë 6.2.1995 i Këshillit të Ministrave "Për rregullat e funksionimit të Këshillit të Ministrave", shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE
E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me:
 - a) përgatitjen dhe paraqitjen e projektakteve, si dhe shqyrtimin e tyre në Këshillin e Ministrave;
 - b) organizimin e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave.
2. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) "Ministri propozues" është ministri që ka filluar procedurat për hartimin e projektaktit dhe pasi ka marrë vlerësimet paraprake, e propozon projektaktin për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave.
 - b) "Nismë propozuese" është ushtrimi i së drejtës ligjore për të hartuar dhe propozuar për shqyrtim e miratim projektakte.
 - c) "Projektakti" është projekti i një ligji, akti me fuqinë e ligjit, sipas nenit 101 të Kushtetutës, vendimi ose udhëzimi që paraqitet për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.
 - ç) "Programi analitik i projektakteve" është lista e projektakteve që parashikohen të hartohen dhe të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, sipas programit të ministrave.

2.1 Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të parashikuara në këtë rregullore, përfshirë edhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, në mungesë dhe me autorizimin e tij, ushtrohen nga drejtuesi në varësi të drejtpërdrejtë, i cili është përgjegjës për çështjet e legjislacionit dhe të akteve rregullatore në Kryeministri.

¹ VKM nr.584, datë 28.08.2003 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.76/2003
VKM nr.201, datë 29.03.2006 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.33/2006
VKM nr.653, datë 14.09.2006 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.178/2016
VKM nr.233, datë 18.03.2015 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.43/2015
VKM nr. 4, datë 07.01.2009 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.2/2009
VKM nr.197, datë 11.4.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.54, datë 17 prill 2018.
VKM nr.613, datë 24.10.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.154, datë 29 tetor 2018
VKM nr. 35, datë 24.1.2024 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, datë 26.1.2024

KREU II NISMA PËR PROJEKTAKTIN

3. Kryeministri dhe çdo ministër kanë të drejtën e propozimit të projektakteve për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

4. Ministrat e ushtrojnë këtë të drejtë në përputhje me fushat e veprimtarisë shtetërore që kanë në kompetencë, si dhe me përgjegjësitë që burojnë nga strategjitë dhe dokumentet e tjera të miratuara për drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Kryeministri e ushtron këtë të drejtë në çdo rast, kryesisht ose kur kjo e drejtë nuk është ushtruar nga ministri përkatës.

5. Projektaktet që përmbajnë normimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore propozohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga Kryeministri. Sipas vlerësimit të tij, bashkëpropozues të projektaktit mund të jenë edhe një ose disa ministra të tjerë.

6. Kur fusha e marrëdhënieve që rregullon projektakti lidhet me veprimtari, të cilat janë në kompetencë të më shumë se një ministri, nisma për propozimin e tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, ushtrohet bashkërisht nga ministrat përkatës.

7. Si rregull, brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik dhe në çdo rast, brenda afatit të caktuar nga Kryeministri, sipas fushës së veprimtarisë që kanë në kompetencë, ministrat i paraqesin Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave projektprogramin e hollësishëm të projektakteve që parashikojnë të propozojnë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në vitin pasardhës. *Projektprogrami duhet të koordinohet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian për ato projektakte, të cilat synojnë përafrim të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian.*

8. Projektprogrami i detajuar i projektakteve për çdo fushë veprimtarie duhet të jetë i ndarë në katërmujorë dhe të përmbajë:

a) listën e projektakteve që parashikohen të propozohen për shqyrtim në Këshillin e Ministrave,
b) afatin e paraqitjes së tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, me qëllim shqyrtimin në mbledhjen e Këshillit të Ministrave;

c) relacion të hollësishëm me shpjegimet e nevojshme lidhur me arsyet kryesore për propozimin e projektaktit, çështjet më të rëndësishme që parashikohen të rregullohen prej tij, përputhshmërinë me programin politik të Këshillit të Ministrave, me programet kombëtare ose sektorale të zhvillimit të vendit. *Nëse një projektakt ka për qëllim zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, relacioni duhet të përmbajë edhe një referencë të qartë për këtë.*

ç) ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore;

9. Kryeministri bashkërendon procesin e përgatitjes së programit analitik të projektakteve dhe e propozon për miratim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

10. Pas miratimit të programit analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, sipas fushës së veprimtarisë që ka në kompetencë, ministri urdhëron miratimin e programit të hollësishëm të masave, afateve dhe strukturave përgjegjëse për zhvillimin e procesit legjislativ në tërësi dhe për çdo projektakt, raportimin për ecurinë e tyre deri në përfundimin e hartimit të projektaktit dhe paraqitjen e tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

10/1. Ministri propozues për projektaktet, të cilat vlerësohen të një rëndësie të veçantë dhe periudha e përgatitjes së tyre është e kufizuar ose që gjatë hartimit dhe bashkërendimit të tyre pritet të ndeshen me çështje tekniko-ligjore të vështira për zgjidhje, planifikon që të organizohen takime bashkërenduese-konsultative për përshpejtimin e procesit, takime të grupit akselerator, sipas pikës 38.1, të kreut V, të kësaj rregulloreje.

11. Ministri propozues ua dërgon projektaktin për mendim ministrave dhe institucioneve të interesuara, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së përcaktuar në programin analitik të miratuar.

KREU III PËRGATITJA E PROJEKTAKTIT

12. Përpara fillimit të procesit të hartimit të projektaktit, strukturat teknike në bashkërendim me strukturën juridike, bëjnë vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektaktit ku përfshihen, ndërmjet të tjerave, shpjegime lidhur me:

a) qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen;

b) përputhshmërinë me programin politik dhe me programin analitik të projektakteve të Këshillit

të Ministrave, *Planin Kombëtar për Integrimin Evropian*, si dhe me strategjitë e programet e miratuara mbi drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore;

- c) pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi;
- ç) parashikimet dhe masat, që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e projektaktit;
- d) shpenzimet buxhetore dhe efektet financiare të pritshme;
- dh) ndikimet ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore të pritshme.

12/1. Në rastin kur parashikohen projektakte të propozuara në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, projektaktet duhet të shoqërohen me tabela të përputhshmërisë, të cilat u mundësojnë strukturave juridike në ministritë e linjës dhe njësitë të integritetit evropian që të identifikojnë shkallën e përputhshmërisë ndërmjet legjislacionit shqiptar dhe acquis të BE-së. Modeli i tabelës së përputhshmërisë është sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.

13. Mbështetur në vlerësimin paraprak të projektaktit, ministri cakton me urdhër të veçantë çështjet që duhen rregulluar, format e pjesëmarrjes dhe hapat kryesore të realizimit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet njerëzore dhe materiale që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e çdo projektakti.

14. Projektaktet hartohen nën përgjegjësinë e strukturës juridike, e cila në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të ministrisë, organizon këshillime me drejtues a specialistë të drejtorive, sektorëve a enteve, si dhe me struktura të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit.

15. Për përgatitjen e projektakteve, struktura juridike mund të kërkojë mendimin e ekspertëve të tjerë, brenda ose jashtë ministrisë.

15.1 Strukturat përgjegjëse gjatë hartimit të një projektakti të paravlerësuar si i rëndësishëm së veçantë, kur ndeshen me çështje tekniko-ligjore të vështira për zgjidhje, njoftojnë ministrin duke argumentuar nevojën që të kërket organizimi i një takimi të grupit akselerator, sipas pikës 38.1, të kreut V, të kësaj rregulloreje.

16. Në bashkërendim me strukturën juridike, strukturat përgjegjëse përpilojnë raportin e vlerësimit të ndikimit të projektaktit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij vendimi, relacionin shpjegues të projektaktit, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare, si dhe plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm shoqërues përpara se t'i dërgohen për shqyrtim ministrit.

17. Në përfundim të konsultimeve dhe shqyrtimit të projektaktit, raportit të vlerësimit të ndikimit të tij, relacionit shpjegues, raportit të vlerësimit ekonomik raportit të rezultatit të takimit të grupit akselerator, kur ka të tillë dhe dokumentacionit shoqërues, ministri pasi vlerëson nismën, vendos dërgimin e tyre për mendim në ministritë dhe institucionet e interesuara ose urdhëron rishikimin e tyre brenda një afati të caktuar prej tij.

18. Projektakti i dërguar për mendim duhet të shoqërohet me raportin e vlerësimit të ndikimit të plotësuar, relacionin shpjegues me të gjitha elementet e tij, si dhe çdo dokument tjetër, sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je.

a) Në rastin e projektakteve në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, projektakti duhet të shoqërohet me tabelat e përputhshmërisë dhe me aktin ligjor të Bashkimit Evropian, i cili synohet të përafrohet, i përkthyer në gjuhën shqipe.

b) Në rastin e projektakteve që duhet të konsultohen me publikun, relacioni duhet të shoqërohet me të dhënat për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, sipas formatit në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

19. Relacioni shpjegues duhet të përmbajë:

a) Qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen.

b) Vlerësimin politik dhe lidhjen ose jo të projektaktit me programin politik të Këshillit të Ministrave, aktet që kanë miratuar drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, si dhe dokumente të tjera për strategjitë dhe politikatat e zhvillimit.

c) Argumentimin e propozimit të projektaktit, duke bërë analizën lidhur me përparësitë dhe problemet e mundshme në zbatimin e projektaktit, nivelin e efektivitetit, zbatueshmërisë, efikasitetit, impaktit dhe efekteve përkatëse, si dhe kostos ekonomike që rezultojnë në raport me legjislacionin në fuqi.

ç) Vlerësimin paraprak të ligjshmërisë dhe përputhshmërisë së formës dhe përmbajtjes së projektaktit me Kushtetutën, harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi dhe me normat e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

d) Për projektaktet normative, vlerësimin e shkallës së përafërimit dhe tabelën e përputhshmërisë me acquis të BE-së. Në rast përafërimit të pjesshëm, duhet të shpjegohen iniciativat e ardhshme që do të ndërmerren deri në përafërimit të plotë të acquisit të BE-së.

dh) Përmbledhje shpjeguese të përmbajtjes së projektaktit.

e) Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit.

ë) *Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektaktit, shpjegime në lidhje me identifikimin e grupeve të interesit, pjesëmarrës në konsultim, kohëzgjatjen e procesit të konsultimit, çështjet e diskutuara dhe opinionet e shprehura nga grupet e interesit, si dhe reflektimin ose jo në projektakt të opinioneve të grupeve të interesit.*

20. Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore duhet të përmbajë:

a) shumën e përgjithshme të shpenzimeve vjetore për zbatimin e aktit;

b) parashikimet e hollësishme për çdo zë të buxhetit, të nevojshme për zbatimin e aktit;

c) kohën e fillimit të efekteve financiare;

ç) shpenzimet e detajuara për strukturat që ngarkohen me zbatimin e aktit;

d) burimet e sigurta dhe të pritshme të financimit;

dh) analizën e rritjes apo të pakësimit të shpenzimeve buxhetore, të paktën për tre vitet e para të zbatimit të tij;

e) vlerën e detyrimeve fiskale të pritshme apo të përjashtuara, që parashikon projektakti;

ë) kur projektakti ka për objekt miratimin e përdorimit apo të shpërndarjes së fondeve publike, shoqërohet me preventivin përkatës.

21. Për projektaktet që kanë objekt miratimin ose ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, plotësimi i të dhënave sipas pikave 19 dhe 20 të kësaj rregulloreje, të përgatiten përpara miratimit të tyre në parim.

21/1. Në tekstin e projektaktit me karakter normativ, që synon përafrimin me acquis të BE-së, shënohen data e miratimit dhe titulli i plotë i instrumentit ligjor të acquis të BE-së, me të cilin është përafruar projektakti, përfshirë numrin CELEX dhe atë natyror. Referenca të instrumentit ligjor i acquis i BE-së bëhet nëpërmjet një shënimi fundor në fund të faqes së parë, të lidhur me titullin e projektaktit. Referenca shënohet edhe në rastin e projektligjeve, që ratifikojnë marrëveshje ndërkombëtare, të cilat janë njëkohësisht pjesë e acquis të BE-së.

KREU IV

DHËNIA E MENDIMEVE PËR PROJEKTAKTIN

22. Të gjitha projektaktet pa përjashtim i dërgohen për mendim Ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet lidhur me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes, për çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legislative dhe për terminologjinë juridike të projektaktit duke parashtruar, kur është rasti, edhe formulimet përkatëse.

22/1. Shfuqizuar.

23. Nëse projektakti shoqërohet me efekte financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, në çdo rast i dërgohet për mendim ministrit përgjegjës për financat dhe, sipas rastit, ministrit përgjegjës për ekonominë.

24. Nëse projektakti përmban çështje që lidhen me disponimin dhe administrimin e pronave publike dhe shtetërore, me financime të huaja dhe marrëdhënie ekonomike me jashtë, si dhe me impakte në ecurinë e zhvillimit të ekonomisë, në çdo rast i dërgohen për mendim ministrit përgjegjës për ekonominë dhe, sipas rastit, ministrit përgjegjës për financat.

25. Projektaktet me karakter normativ, që synojnë përafrimin me acquis të BE-së në legjislacionin vendas, i dërgohen për mendim ministrit përgjegjës për çështjet e integritetit evropian. Projektaktet shoqërohen me relacionin dhe me tabelën e përputhshmërisë për verifikimin dhe konfirmimin e shkallës së përputhshmërisë së tyre me acquis të BE-së.

Projektaktet e nxjerra nga ministri i linjës, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, para miratimit të tyre, i dërgohen, gjithashtu, për mendim ministrit përgjegjës për çështjet e integritetit evropian, kur ato synojnë përafrimin me acquis të BE-së, të shoqëruara me relacionin dhe tabelën e përputhshmërisë, për verifikimin dhe konfirmimin e shkallës së përputhshmërisë së tyre me acquis të BE-së.

Projektaktet e pashoqëruara me relacionin dhe tabelën e përputhshmërisë me acquis të BE-së i kthehen nga ministri përgjegjës për çështjet e integritetit evropian institucionit propozues për plotësime të mëtejshme, përpara shqyrtimit nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave nuk shqyrton asnjë projektakt, që synon përafrimin me acquis të BE-së, nëse nuk është marrë më parë mendimi i ministrit përgjegjës për çështjet e integritetit evropian.

26. Të gjitha projektaktet me objekt miratimin në parim të marrëveshjeve ndërkombëtare i dërgohen për mendim ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

27. Projektaktet me përmbajtje shoqërore, me efekte në burime njerëzore, i dërgohen për mendim ministrit përgjegjës për punën dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale, si dhe Departamentit të Administratës Publike.

27.1 Për projektaktet e vlerësuara të një rëndësie të veçantë dhe me prioritet shqyrtimi, ministri propozues bën shënimin përkatës në dokumentin shoqërues të dërgimit të projektaktit për mendim.

KREU V BASHKËRENDIMI I PROJEKTAKEVE

28. Ministrat dhe titullarët e institucioneve të interesuara ia dërgojnë mendimin e tyre për projektaktin ministrit/ ministrave propozues, në formë shkresore dhe elektronike, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga data e marrjes nëpërmjet sistemit e-akte të projektaktit dhe të kërkesës për mendim që e shoqëron atë. Për ministrin e Drejtësisë, ministrin përgjegjës për çështjet e integritetit evropian dhe ministrin përgjegjës për financat, ky afat është 10 (dhjetë) ditë pune. Nëse, pas mbarimit të afatave të sipërpërmendura, mendimi i kërkuar nuk është dhënë, do të konsiderohet se ministri përkatës është dakord dhe pa vërejtje për projektaktin, me përjashtim të ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet për aktin.

29. Mendimet e ministrave dhe institucioneve të interesuara përmbajnë vërejtje, komente ose sugjerime për çështje teknike të formës dhe përmbajtjes së projektaktit, raportit të vlerësimit të ndikimit të tij, relacionit shpjegues, raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe dokumentacionit tjetër shoqërues duke u përqëndruar, si rregull, në dhënien e mendimit të specializuar sipas fushave përkatëse të veprimtarisë që kanë në kompetencë.

29.1 Ministri ose titullari i institucionit të interesuar për projektaktet e rëndësishë së veçantë, të dërguara sipas pikës 27.1, të kreut IV, të kësaj rregulloreje, kur në përmbajtje të tyre ndeshet me çështje tekniko-ligjore të vështira për dhënie mendimi për zgjidhjen e tyre, brenda fushës së tij të përgjegjësisë, i propozon ministrit iniciues të projektaktit që të kërkojë organizimin e një takimi të grupit akselerator për gjetjen sa më parë të zgjidhjeve përfundimtare të çështjeve, objekt diskutimi.

30. Projektakti ripunohet duke marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e ministrave dhe të titullarëve të institucioneve të tjera të interesuara. Vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga Ministri i Drejtësisë dhe sipas rastit ministrat e treguar në pikat 23 deri 27 të kësaj rregulloreje, shihen me përparësi gjatë ripunimit të projektaktit.

31. Mendimi juridik i Ministrit të Drejtësisë, lidhur me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së projektaktit, reflektohet në ripunimin e projektaktit nga ministri propozues, duke zhvilluar për këtë qëllim, nëse çmohet e nevojshme, konsultime të përbashkëta ose ridërguar atë për mendim përfundimtar.

Mendimi i ministrit përgjegjës për çështjet e integritetit evropian për vlerësimin ose shkallën e përafrimit të projekteve normative me acquis të BE-së reflektohet në projektaktin e ripunuar nga ministri propozues. Nëse është e nevojshme, mund të zhvillohen konsultime të përbashkëta për këtë qëllim.

Në rastin kur projektakti ripunohet nga ministri propozues për të reflektuar mendimet e ministrave të linjës në projektin përfundimtar të tij, edhe kur ministria përgjegjëse për çështjet e integritetit evropian ka shprehur sugjerimet e saj për përpunueshmërinë e tij me acquis të Bashkimit Evropian, projektakti përfundimtar i ridërgohet ministrit përgjegjës për çështjet e integritetit evropian për mendim përfundimtar, përpara dërgimit të tij për shqyrtim në Këshillin e Ministrave. Shtojca "Modeli i relacionit dhe tabelës së përpunueshmërisë së projektaktit normativ me acquis të Bashkimit Evropian, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet pjesë e rregullores së Këshillit të Ministrave.

32. Në rastin e dhënies së mendimeve që synojnë të propozojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht thelbin e përmbajtjes së projektaktit, ministri duhet të paraqesë për çdo çështje edhe argumentet përkatëse dhe kur është rasti, riformulimet e nevojshme të dispozitave të projektaktit.

33. Kur nga përmbajtja e mendimeve të dërguara nga ministrat dhe titullarët e institucioneve të interesuara, rezulton se ato sugjerojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht thelbin e përmbajtjes së projektaktit, ministri propozues mund të vendosë:

a) tërheqjen e plotë ose të pjesshme të propozimit të projektaktit;
b) rishikimin e përmbajtjes së tij edhe me anë të konsultimeve me ministrat përkatës;
c) kur çmon se nga procesi i konsultimeve sipas shkronjës "b" të kësaj pike nuk zgjidhen kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet ose zgjidhjet alternative të sugjeruara ose kundërshtimet janë të paargumentuara, i dërgon menjëherë Kryeministrit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, kërkesën e motivuar për bashkërendimin e qëndrimeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tij dhe ministrave përkatës, së bashku me projektaktin dhe dokumentacionin sipas pikës 45 të kreut VI të kësaj rregulloreje;

c) për projektaktet e rëndësishë së veçantë dhe prioritare, me propozim të ministrit apo titullarit që ka dhënë mendim

ose me nismën e tij kërkon organizimin e takimit të grupit akselerator, sipas pikës 38.1, të këtij kreu të rregullores.

34. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave kur vëren se projektakti dhe dokumentacioni që e shoqëron nuk përmbush kriteret e pikës 47, shkronjat "a" dhe "b" të kreut VI të kësaj rregulloreje, vendos kthimin e motivuar të projektaktit ministrit propozues.

35. Kur projektakti dhe dokumentacioni që e shoqëron është i plotë, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave vendos dërgimin e tij për shqyrtim nga Kryeministri, duke i bashkëlidhur një relacion shpjegues teknik për përmbajtjen, problematikën dhe zgjidhje të mundshme të sugjeruara lidhur me kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet e evidentuara.

36. Kryeministri vendos sipas rrethanave:

a) thirrjen në konsultë të ministrave të interesuar dhe personave të tjerë që çmohen prej tij, përpara se të marrë vendimin përkatës;

b) delegimin e zgjidhjes së çështjeve Zëvendëskryeministrit ose Sekretarit të Përgjithshëm, kur thelbi i kundërshtive lidhet vetëm me çështje të ligjshmërisë. Së bashku me delegimin, Kryeministri cakton edhe modalitete dhe afatet përkatëse të kësaj procedure dhe për raportin e rezultateve që duhet t'i paraqiten për miratim ose vendimarrje;

b.1) delegimin e zgjidhjes së çështjeve tekniko-ligjore të vështira në grupin akselerator;

c) dërgimin e projektaktit për shqyrtim dhe konsultim më të gjerë në komitetet ndërministrorë.

37. Në rastin e shkronjes "a" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, ministri propozues dhe ministrat e titullarët e tjerë të institucioneve të interesuara marrin masa për zbatimin e vendimit të Kryeministrit në mënyrën dhe afatin e caktuar prej tij.

38. Në rastin e shkronjës "b" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, autoriteti i deleguar organizon konsultimin me pjesëmarrjen e ministrave të interesuar dhe funksionarëve të tjerë politikë dhe sipas rastit, të departamentit juridik dhe atij të koordinimit në aparatin e Këshillit të Ministrave, të strukturave juridike dhe teknike të ministrave të interesuara dhe personave të tjerë që mund të japin kontribut në zgjidhjen e çështjes. Në përfundim të konsultimit, autoriteti i deleguar i raporton me shkrim Kryeministrit duke propozuar për miratim ose vendimarrje zgjidhjet eventuale të çështjes.

38/1. Në rastet e shkronjës "ç", të pikës 33, dhe të shkronjës "b.1", të pikës 36, të kësaj rregulloreje, zëvendëssekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me marrjen e kërkesës ose të delegimit organizon takimin e grupit akselerator për zgjidhjen e çështjes/ve të kërkuara ose të deleguara.

Grupi akselerator kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe në përbërje ka zëvendëssekretarin e përgjithshëm, përgjegjës për mbarëvajtjen e takimit, ministrin/at propozues të projektaktit, ministrin ose titullarin e institucionit që në mendimin me shkrim ka evidentuar çështjet, objekt shqyrtimi, dhe drejtorin e Departamentit të Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave në Kryeministri.

Në varësi të çështjeve që diskutohen, në takimin e grupit akselerator mund të thirren ose ftohen të marrin pjesë titullarë të institucioneve të fushave me interes ose punonjës të administratës apo ekspertë të jashtëm që vlerësohen se mund të ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve tekniko-ligjore.

Takimi i grupit akselerator asistohet nga departamenti përgjegjës në Kryeministri, i cili për gatit materialin për diskutim dhe nën kujdesin e zëvendëssekretarit të përgjithshëm harton dhe i dërgon anëtarëve të grupit akselerator raportin përkatës të rezultatit të takimit.

Rezultatet e takimit akselerator për zgjidhjen e çështjeve, objekt diskutimi, reflektohen në përmbajtje të projektaktit dhe të mendimeve me shkrim të ministrave dhe titullarëve të institucioneve të interesuara, pjesëmarrës në takim.

39. Në rastin e shkronjës "c" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave merr masat për përfshirjen e çështjes në rendin e ditës dhe organizimin e mbledhjes së Komitetit Ndërministror, sipas modaliteteve dhe afateve të caktuara nga Kryeministri.

40. Nëse është e nevojshme, sipas urdhërimeve të Kryeministrit, Sekretari i Përgjithshëm kujdeset për reflektimin teknik të zgjidhjeve të arritura, me pjesëmarrjen, sipas çmimit të tij të departamentit juridik dhe atij të koordinimit në aparatin e Këshillit të Ministrave, të strukturave juridike dhe teknike të ministrave dhe institucioneve të interesuara ose ekspertëve të tjerë.

41. Në përjashtim nga rregulli i përgjithshëm dhe për arsye të motivuara, për çështje dhe projekte të një rëndësie të veçantë, Kryeministri nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë përfshirjen e tyre në rendin e ditës së mbledhjes së Komitetit Ndërministror dhe shpërndarjen e materialeve të tij, pa kërkuar përmbushjen ose plotësimin e një apo më shumë elementeve të procedurave të bashkërendimit paraprak. Në këtë rast, ministri propozues, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, duhet t'u shpërndajë anëtarëve të komitetit kopje të

projektit, të relacionit dhe të materialeve shoqëruese, në çastin që njoftohet data dhe rendi i ditës për mbledhjen e komitetit ndërmnistror.

42. Nëse projektakti miratohet në komitetin ndërmnistror, paraqitet për miratim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Ministrave. Kur për projektin nga Komiteti Ndërmnistror janë bërë vërejtje, ministri propozues i reflekton ato dhe paraqet projektin e ripunuar, së bashku me materialet shoqëruese, për miratim në Këshillin e Ministrave.

42/1. Projektakti, pas marrjes së mendimeve të ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, së bashku me dokumentacionin sipas pikës 45, të kreut VI, të kësaj rregulloreje, i paraqitet për konsultim dhe vlerësim grupimit ministror, ku bën pjesë edhe ministri propozues.

KREU VI PARAQITJA E PROJEKTAKTEVE PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE

43. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

44. Projektakti, *raporti i vlerësimit të ndikimit*, relacioni shpjegues, dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të kësaj rregulloreje, në dy kopje origjinale, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

45. Propozimet e projekteve shoqërohen me:

a) projektaktin e bashkërenduar me ministrinë përkatëse;

b) relacionin shpjegues, i cili përveç të dhënave të parashikuara në pikat 19 dhe 20 të kreut të tretë të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë edhe shpjegime për mënyrën e zbatimit dhe reflektimit të raportit të rezultetit të takimit të grupit akselertor si dhe për arsyet e mosreflektimit të vërejtjeve ose sugjerimeve të bëra nga ministrinë e interesuara;

c) mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara me përjashtim të rasteve kur, për shkak të mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 28, do të konsiderohet se ministri përkatës është dakord dhe pa vërejtje për projektaktin. Në çdo rast mendimi i Ministrisë të Drejtësisë duhet të shoqërojë projektaktin;

c) tekstin e plotë të traktatit a marrëveshjeve ndërkombëtare, në gjuhë të huaj dhe në shqip, të vërtetuar zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, kur projektakti ka këtë objekt.

d) Raportin e vlerësimit të ndikimit të projektaktit, sipas formatit në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

45/1. Përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit sipas shkronjës "d", të pikës 45, të këtij vendimi, projektaktet që kanë të bëjnë me një nga kategoritë e mëposhtme:

a) Projektakte që trajtojnë çështje, të cilat lidhen me informacionin e klasifikuar shtetëror, çështje të sigurisë kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë;

b) Projektakte që lidhen me situata emergjente, fatkeqësi natyrore apo gjendje të krizës;

c) Projektakte që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomatike, veçanërisht ratifikime të marrëveshjeve ndërkombëtare apo çështje që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare;

c) Projektakte që lidhen me menaxhimin buxhetor, projektligji për buxhetin vjetor dhe aktet nënligjore që dalin në zbatim të tij, projektaktet që lidhen me programimin buxhetor afatmesëm, projektaktet që prekin tatimet dhe tarifatat doganore;

d) Projektakte që prekin legjislacionin penal;

dh) Projektakte që kanë efekt zbatimi të përkohshëm dhe kalimtar.

46. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, kur vëren se dokumentacioni që shoqëron projektaktin është i plotë, e pranon atë për shqyrtim paraprak.

47. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave vendos kthimin e projektaktit ministrit propozues, vetëm kur:

a) mungon njëri nga dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të këtij kreu të rregullores;

b) nuk është respektuar forma dhe përmbajtja e parashikuar në këtë rregullore për përgatitjen dhe hartimin e projektakteve, raportit të vlerësimit të ndikimit, relacionit shpjegues dhe dokumenteve sipas pikave 19, 20 dhe vijuese të kësaj rregulloreje;

b.1) nuk janë reflektuar me korrektësi rezultatet e takimit të grupit akselertor, kur ka të tillë.

c) projektakti nuk është në pajtim me Kushtetutën, vjen në kundërshtim ose nuk është në harmoni

me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e brendshëm;

ç) mangësitë e projektaktit, veçanërisht atyre me përmbajtje voluminoze, nga pikëpamja e teknikës legjislative, janë shumë të dukshme dhe të pranishme gjatë gjithë përmbajtjes së tij.

48. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave mund ta korrigjojë projektaktin në drejtim të teknikës legjislative dhe të terminologjisë së përdorur, por në asnjë rast nuk duhet të cenojë thelbin e tij.

48/1. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave mund të konsultojë projektaktet që do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, në takimet javore me sekretarët e përgjithshëm të ministrave apo titullarët e institucioneve të interesuara, për problematikat që lidhen me përmbajtjen e projektaktit, qartësimin e aspekteve teknike të tij dhe mungesën e bashkërendimit me ministritë përkatëse.

49. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për qartësimin e aspekteve teknike të përmbajtjes së projektaktit, thërret në konsultë strukturat juridike dhe teknike të ministrisë propozuese.

50. Për projektaktet me rëndësi të veçantë, Kryeministri i vënë në dijeni nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, shqyrton propozimin në bazë të disa kriterëve lidhur me urgjencën e propozimit, kërkesën e publikut, plotësimin e objektivave të politikave kombëtare të zhvillimit, mundësisë së zbatimit të shpejtë etj.

Këto projektakte mund të diskutohen në rrethe të gjera, ku mund të përfshihen përfaqësues të institucioneve shtetërore, OJF-ve, ekspertë të institucioneve ose organizatave ndërkombëtare etj.

51. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, kur vëren se ministrat ose drejtuesit e institucioneve të interesuara janë shprehur me shkrim kundër projektaktit, e dërgon projektin për bashkërendim sipas procedurave të parashikuara në kreun e pestë të kësaj rregulloreje.

KREU VII RENDI I DITËS

52. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në bazë të projektakteve dhe të çështjeve të paraqitura nga anëtarët e Këshillit të Ministrave, përgatit rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave dhe ia paraqet për miratim Kryeministrit.

53. Si rregull, projektaktet përfshihen në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave, nëse janë dërguar pranë Sekretarit të Përgjithshëm, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Për arsye të motivuara dhe me miratimin paraprak të Kryeministrit, në rendin e ditës përfshihen projektakte të dërguara edhe pas afatit 10 ditor.

54. Rendi i ditës i mbledhjes, së bashku me materialet që do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, i dërgohet nga Sekretari i Përgjithshëm çdo anëtar të Këshillit të Ministrave, jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për thirrjen e mbledhjes.

55. Për mbledhjet e jashtëzakonshme rendi i ditës shpërndahet jo më vonë se 2 orë përpara orës së caktuar për mbledhje.

56. Rendi i ditës përmban:

- a) Tematikën që do të trajtohet.
- b) Datën dhe orën e caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave.
- c) Listën e titujve të projektakteve që do të shqyrtohen në mbledhje.
- ç) Listën e çështjeve dhe të problemeve që do të diskutohen.

57. Rendi i ditës nënshkruhet nga sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

58. Kryeministri, në kushte dhe rrethana të paparashikuara, mund ta ndryshojë rendin e ditës.

59. Çështjet e rendit të ditës të mbetura pa u shqyrtuar në mbledhjen e radhës së Këshillit të Ministrave kalojnë automatikisht në mbledhjen pasardhëse, me përjashtim të rastit kur Kryeministri vendos ndryshe.

60. Si rregull, shqyrtimi i çështjeve të rendit të ditës së mbledhjeve të Këshillit të Ministrave fillon me shqyrtimin e çështjeve të mbetura nga mbledhjet e mëparshme, kur ka të tilla me përjashtim të rasteve kur drejtuesi i mbledhjes vendos ndryshe.

61. Në njoftimin e rendit të ditës së mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, Sekretari i Përgjithshëm vendos shënimin për çështjet e mbetura për shqyrtim nga mbledhjet e mëparshme.

KREU VIII

DISKUTIMI I PROJEKTAKTEVE NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

62. Drejtuesi i mbledhjes paraqet thelbin e projektaktit, i kërkon ministrit propozues, nëse ka komente lidhur me propozimin e tij dhe më pas fton anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave për të shprehur mendimin e tyre.

63. Pas përfundimit të diskutimit, drejtuesi i mbledhjes fton ministrat për votimin e projektaktit.

64. Në përfundim të shqyrtimit të projektaktit, Këshilli i Ministrave vendos:

- a) miratimin në gjendjen e paraqitur;
- b) miratimin me ndryshime;
- c) shtyrjen për një shqyrtim të mëvonshëm;
- ç) mosmiratimin.

65. Mbledhja e Këshillit të Ministrave regjistrohet në procesverbal me stenografi dhe në rrugë elektronike.

KREU IX

BOTIMI DHE SHPËRNDARJA E AKTEVE

66. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave merr masa për:

- a) zbardhjen e të gjitha akteve të Këshillit të Ministrave;
- b) rregullimin e akteve të miratuara me ndryshime;
- c) nënshkrimin e akteve;
- ç) shpërndarjen e tyre në institucionet që kanë detyrime ose lidhje me përmbajtjen e aktit.

67. Sekretari i Përgjithshëm merr masat për botimin e të gjitha akteve normative të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare brenda afateve ligjore, si dhe në organe të tjera botuese, brenda një kohe sa më të shkurtër.

68. Shpërndarja zyrtare e akteve bëhet nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm, jo më vonë se dy ditë pas nënshkrimit të tyre.

DISPOZITA KALIMTARE

(Shtuar me VKM nr.197, datë 11.4.2018)

1. Përgjashtimisht, për vitin 2018, do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të ndikimit vetëm projektligjet e përcaktuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, sipas programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2018.

2. Deri në vitin 2019, projektaktet që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të ndikimit, do të jenë vetëm projektligjet.

SHTOJCË

MODELI I RELACIONIT DHE TABELËS SË PËRPUTSHMËRISË SË PROJEKTAKTIT NORMATIV ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPLAN

(Bëhet pjesë e rregullores së Këshillit të Ministrave nëpërmjet VKM nr.233, datë 18.03.2015, pika 4/c)

1. Evidentimi i institucionit përgjegjës për përgatitjen e projektaktit ose rishikimin e aktit dhe institucioneve bashkëpunuese

Është i detyrueshëm:

a) emërtimi i ministrisë ose institucionit qendror, përgjegjës për përgatitjen e projektaktit ose rishikimin e aktit, si dhe emërtimi/et e njësive të brendshme të organit të cilat kanë përgatitur projektaktin ose rishikuar aktin;

b) përcaktimi nëse institucioni në fjalë është përgjegjës i vetëm (juridiksion ekskluziv) apo nëse projektakti (akti) është përgatitur në bashkëpunim me dy ose më shumë institucione të administratës shtetërore (juridiksion i përbashkët);

c) identifikimi i institucioneve të administratës shtetërore që kanë marrë pjesë në përgatitjen e projektaktit (në rastet e juridiksionit të përbashkët).

Është fakultative: Përshkrimi për procesin e këshillimit (ngritja e grupeve të punës, përfshirja e shoqërisë civile etj.).

Përmbledhje: Përshkrim i shkurtër i nevojës, angazhimit apo detyrimit ligjor për hartimin e aktit, duke shpjeguar gjithashtu dhe rolin e institucioneve të përfshira në përgatitjen e tij.

Autoriteti drejtues: Emërtimi i institucionit propozues apo drejtues të grupit ad-hoc të punës për përgatitjen e projektaktit.

Autoritetet bashkëpunuese: Emërtimi i institucioneve të përfshira në përgatitjen e projektaktit.

2. Statusi i projektaktit të propozuar në rendin ligjor.

Është i detyrueshëm: Tregimi i pozicionit të aktit normativ në rendin ligjor të brendshëm.

- Në rastin kur projektakti normativ është hartuar në zbatim të një ligji të miratuar nga Kuvendi, duhet të përmendet ligji (titulli i plotë dhe data e botimit në Fletoren Zyrtare) dhe nenet (numri) që do të ekzekutohen.

- Në rastin kur projektakti normativ zbaton një VKM, duhet të përmendet VKM-ja (titulli i plotë dhe data e botimit në Fletoren Zyrtare) dhe nenet (numri) që do të zbatohen.

- Në rastin kur projektakti normativ shfuqizon dispozita të mëparshme, duhet të paraqiten (tregues të përgjithshëm për të identifikuar projektaktin normativ nga pjesët e akteve normative që do të shfuqizohen).

- Në rastin kur projektakti normativ është një shkrimje (amendim apo konsolidim) i akteve të tjera normative (të përmendet numri, data dhe titulli i shkurtër i akteve të amenduara).

Përmbledhja duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Projektakti (titull i shkurtër) paraqet një amendim të ligjit nr. / datë/ titull i shkurtër.

Ose

- Projektakti (titull i shkurtër) zbaton dispozitat e ligjit (ose VKM) (nr. / datë/ titull i shkurtër) për sa i takon (të përmendet shkurtimisht fusha e neneve që do të zbatohen).

Ose

- Projektakti (titull) shfuqizon ligjin (ose VKM) (nr. / datë/ titull i shkurtër).

Ose

- Projektakti është një shkrimje (amendim apo konsolidime) e dispozitave të ligjit/ VKM (nr. / datë/ titull i shkurtër) dhe ligjit/ VKM (nr. / datë/ titulli i shkurtër).

3. Relacioni i projektaktit:

- Objektivat e propozimit:

Objektivat e përgjithshëm që synon të rregullojë projektakti (të cilat mund të jenë: modernizimi, racionalizimi, trajtimi i një çështjeje, rregullimi i aktivitetëve informuese etj.).

Objektivat specifike në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (duhet të përmenden dispozitat e MSA-së të cilat synohen të adresohen përmes projektaktit normativ; angazhimet e ndërmarra në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian; mangësitë e vëna në dukje nga Bashkimi Evropian në raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, si dhe takimet e formateve të ndryshme Shqipëri-BE).

Hapat e mëparshëm të ndërmarrë për përafrimin e legjislacionit (duhet të shpjegohet nëse projektakti përfaqëson fazën e parë/ të dytë/ të tretë — për përafrimin e legjislacionit vendas me rregulloren(t) direktivën(at) nr..., siç është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian).

Ndryshimet e mundshme ose të pritshme të legjislacionit në fuqi si pasojë e miratimit të projektaktit.

Gjithashtu, në rastet kur një pjesë e dispozitave të legjislacionit vendas që do të amendohet apo do të konsolidohet (Kodi Civil, Kodi Tregtar, Kodi Penal etj.) janë të përafëruara me acquis-në e BE-së, duhet të përmenden dhe të analizohen dispozitat që nuk shfuqizohen në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të këtij akti.

- Përshkrimi i hapave kryesorë të ndërmarrë për përgatitjen e projektaktit normativ.

Ky përshkrim duhet të përfshijë:

a) modelet e akteve të ngjashme të vendene anëtare të Bashkimit Evropian dhe/ose të vendene kandidate të marra parasysb gjatë hartimit të projektaktit;

b) përkthimet në gjuhën shqipe të acquis që përafrohet përmes projektaktit normativ;

c) ekspertizën e buaj ose vendase të siguruar me sugjerimin e donatorëve (kur shihet e arsyeshme).

Këto dokumente duhet t'i bashkëlidhen projektaktit.

- Shkalla e synuar e përputhshmërisë me acquis të BE-së

Kur synohet përafrim i pjesshëm i projektaktit normativ me acquis, duhet të pasqyrohen objektivat e përgjithshëm të projektaktit normativ (të përmenden duke cituar dhe analizuar në mënyrë krahasimore pjesët e legjislacionit të BE-së me të cilat do të përafrohet projektakti normativ).

Ose

Kur synohet përafrim i plotë i projektaktit normativ me acquis, duhet të inkorporohen/ të transpozohen/ të adoptohen dispozitat e evidentuara të legjislacionit të BE-së në projektaktin normativ (të citohen nenet e aktit legjislativ të BE-së, si dhe të

bëhet një përmbledhje e dispozitave të projektaktit normativ me aktin legjislativ të BE-së).

- Përcaktimi i shkallës së përputhshmërisë bëhet sipas këtyre rregullave:

a) “Plotësisht i përputhshëm” — projektakti normativ është në përputhje të plotë (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të *acquis* të BE-së dhe është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

b) “Pjesërisht i përputhshëm” — projektakti normativ është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të *acquis* të BE-së, megjithëse nuk përputhet me të gjitha parimet që rrjedhin prej tyre, por vetëm me ato më të rëndësishmet.

c) “I papërputhshëm” — projektakti normativ është i papërputhshëm pasi nuk përafron *acquis*-në e BE-së.

- Arsyet për përputhshmëri të pjesshme ose për mospërputhje

Nëse synohet përafrim i pjesshëm i projektaktit normativ me *acquis* ose nuk synohet përafrim i projektaktit normativ me *acquis*, organi kompetent duhet të përcaktojë arsyet, pavarësisht nëse janë ekonomike, financiare, sociale ose të tjera. Arsyetimi duhet të shoqërohet nga referenca në analiza specifike impakti, studime ose dokumente të tjera dhe jo vetëm në konstatimin e arsyes/ve në terma të përgjithshëm.

- Hapat e mëtejshëm të parashikuar për përafrimin gradual deri në përafrimin e plotë të projektaktit normativ.

Duhet të përcaktohet analiza e boshllëqeve për të evidentuar përmbajtjen e fazave të mbetura dhe periudhën kohore brenda së cilës do të adresohet përafrimi i plotë.

4. Kur projektakti i përgatitur synon përafrimin me *acquis*-në e BE-së, institucioni përgjegjës plotëson tabelën e përputhshmërisë sipas modelit të dhënë në këtë shtojcë.

5. Tabelat e përputhshmërisë përgatiten njëkohësisht në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

6. Institucioni propozues kujdeset që të reflektojë në tabelën e përputhshmërisë çdo ndryshim që pëson projektakti normativ gjatë procesit të konsultimeve dhe miratimit.

7. Hartuesit e projektaktit normativ dhe njësitë e integritetit evropian sigurohen që tabela e përputhshmërisë të jetë plotësuar saktë, para se t’i dërgohet ministrisë përgjegjëse për çështjet e integritetit evropian për të verifikuar përputhshmërinë.

8. Pas miratimit të projektaktit, tabelat e përputhshmërisë (në gjuhën shqipe dhe atë angleze) depozitohen në formë elektronike pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e integritetit evropian në bazën e të dhënave të tabelave të përputhshmërisë.

9. Plotësimi i tabelës së përputhshmërisë synon:

a) lehtësimin e parashikimit dhe analizimit të përputhshmërisë së një projektakti me disa pjesë të legjislacionit të BE-së dhe anasjelltas;

b) përcaktimin sa më të plotë dhe të qartë të shkallës së përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis*-në e BE-së dhe lehtësimin e procesit të monitorimit dhe raportimit në shërbimet e Komisionit Evropian;

c) lehtësimin e krijimit të një baze të dhënash të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së;

ç) përgatitjen institucionale për përballimin e fazave të mëtejshme të procesit të integritetit evropian (procesit “screening” dhe negociimit të kapitujve të *acquis* të BE-së për anëtarësimin në BE).

10. Tabela e përputhshmërisë (në shqip dhe anglisht).

Tabela

Acquis së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare)		Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit)				
		Shkalla e përafrimit (një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime

Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të <i>acquis</i> së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit.	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.	Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës	Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projekaktit	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafuar kërkesat e nenit të <i>acquis</i> së BE-së në kolonën e dytë.	Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafrimit për çdo nen të veçantë.	Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafrimit. Kur përafrimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafrimi i plotë.

Table of concordance

EU <i>acquis</i> CELEX no. Natyral no. Full title Directive XX/XXX/XXX of XXX December 1982		Albanian Legislation 0.1. XXX F - full compliance P - partial compliance N - non compliance				
1	2	3	4	5	6	7
Article	Text	Reference	Article	Content	Conformity	Remarks

Article 1 Paragraph 1						
Article 1 Paragraph 2						

SHTOJCA 1
TABELA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE NË FUNKSION TË HARTIMIT TË
RAPORTIT PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK
(Shtojca bashkëlidhur vendimit nr.653, datë 14.09.2016)

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj për ...
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e ...
FAZA E POLITIKËS/E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim/konsultim/finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva XXX e BE-së/jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	[Jepni titullin e strategjisë ose të dokumentit të politikave që ka të bëjë me projektligjin]
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	[Data/asnjë konsultim publik]
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[Data e përfundimit të vlerësimit të ndikimit/data kur është përgatitur versioni i fundit të vlerësimit të ndikimit]
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	XXXX
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[Viti – ML- nr. VN]
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL-I, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Emri, mbiemri, e-mail-i dhe numri i telefonit:
PJESA 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	
OBJEKTIVAT <i>Cilët janë objektivat dhe efektet e synuar të propozimit?</i>	
OPSIONET E POLITIKAVE <i>Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krabasimin e avantazheve/ të përfitimeve kryesore dhe të dezavantazheve/ kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.</i>	
ANALIZA E NDIKIMEVE <i>Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.</i>	
ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR <i>Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.</i>	
Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lekë, çmimet aktuale, në terma nominalë):	

Viti 1	Viti 2	Viti 3
p.sh., 300 000	p.sh., 300 000	p.sh., 100 000
KONSULTIMI <i>Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?</i>		
ZBATIMI DHE MONITORIMI <i>Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?</i>		

(Shtuar shtojca me VKM nr.197, datë 11.4.2018)

PJESA 2. BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Problemi në shqyrtim

- *Përsbikruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përsbikruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria/biznesi /shoqëria civile /qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Objektivi i politikës

- Vendosi objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.
 - Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.
-
-
-
-
-
-
-
-
-
-

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- Përshkruani opsionin e status quo-së.
 - Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
 - Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.
-
-
-
-
-
-
-
-
-
-

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.

- [illegible]

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

- [illegible]

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

- [illegible]

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/ treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

[illegible]

Tabela. Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krabasuar me status quo-në.

[illegible]

Kostoja për biznesin – në vazhdim										
Kostoja për grupet e tjera – një herë										
Kostoja për grupet e tjera – në vazhdim										
Kostoja në total										
Kostoja e zbritur në total = Kostoja në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kostoja për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë. Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kostoja	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			